KËRKESË
Nr. 1534, datë 17.3.2017

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës shpall kërkesën për shpronësimet, për interes publik, të pasurive pronë private, që preken nga "Ndërtimi i kolektorit kryesor të ujërave të zeza dhe I.T.U.P. në zonën turistike Gjiri i Lalëzit, Durrës" për pasurinë e llojit "arë".

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës-Kanalizimeve.

Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit për pasuritë, pronë
private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", të ndryshuar, për pronarët sipas listave emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës).

Ky publikim bëhet për pasuritë e llojit "arë".

Pronarët do të kompensohen për efekt shpronësimi, pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjellës-Kanalizimeve (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik").

Vlera totale e shpronësimit është **4 158 575** (**katër milionë e njëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e pesë**) lekë.

ZËVENDËSMINISTRI I TRANSPORTIT
DHE INFRASTRUKTURËS
Bahri Shaqiri

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

Lista e pronarëve që preken nga "Ndërtimi i kolektorit kryesor të ujërave të zeza dhe I.T.U.P. në zonën turistike Gjiri i Lalëzit, Durrës"

Nr.	Pronari		Z.K.	Nr.pas	Lloji i pas.	Sip.totale (m2)	Sip. e shpronësimit (m2)	Çmimi (lekë/m2)	Vlera totale (lekë)	Shënime
	Emri	Mbiemri								
1	Zihni Besnike Devis Rexhep Klodjan	Dana	2332	527/10	Arë	10475	10475	397	4158575	Konfirmuar nga ZVRPP
	SHUMA TOTALE						10475		**4158575**	